

FERHAT DINOSHA  
**GJYSMA E RRUGËS**

POEZI

---

BOTIMET TOENA



FERHAT DINOSHA

# GJYSMA E RRUGËS

poezi

BOTIMET TOENA

Tiranë 2025

Botuese: Irena Toçi

Redaktor letrar: Behar Gjoka

Përkujdesja grafike dhe kopertina: Elsa Hajderaj

ISBN 9789928817976

© Autori

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjeti apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA

Rr. “M. Gjollesha”, nr. 71

Tiranë 1023.

K. Postare 1420.

Tel.: + 355 677070884

Email: [botimet.toena@gmail.com](mailto:botimet.toena@gmail.com)

[toena.porosionline@gmail.com](mailto:toena.porosionline@gmail.com)

<https://toena.al>

## DY FJALË

Përmbledhja poetike “Gjysma e rrugës” e autorit Ferhat Dinosha, një figurë e përveçme e politikës dhe dëshmisë atdhetare, në kuptimin e parë, është një pashaportë e pazakontë shpirtërore, fillimisht e jetuar, në motet e qëndresës dhe dhembjeve të pakufijshme, e tanimë e gdhendur në vargje, e fatit individual, pandarazi diçka më shumë, e fatit të qenies shqiptare në këto troje, të gadishullit Ilirik. Shenja më përfaqësuese që paraqet materia e librit, e shtrirë në gjithë hapësirën, është sublimimi i dashurisë për atdhe, për kombin, në të gjitha përmasat ekzistenciale, ku i thuhet bukës bukë e ujit ujë. Metafora e përveçme e titullit, në pamje të parë, është caku ku shohim jetën e njeriut që nuk rreshti së menduari dhe vepruari, për asnjë moment për lirinë e shqiptarëve, kudoqë jetojnë, por tanimë të derdhur në fjalë, në vargje, përmallimi dhe krenarie të ligjshme, për sa munda dhe për ato që shkruan. Teksa shfleton faqet e librit, materien e larmisë poetike, atypëratyshëm ke ndjesinë e një pasqyre, ku vargjet skicojnë rrugën e jetës së autorit, e një jete të jetuar intesivisht, në emër të lirisë së kombit, lirisë së shqiptarëve, pra një paqsyre ku përthyeret njeriu veprimtar, e më në fund në morinë e poezive rishkruhet jeta e njeriut të paepur.

Megjithatë, si nënshtrat i poetikës së vargjeve, me shumë gjasa shestimi thelbësor, është edhe ndryshimi i rrjedhave të çështjes shqiptare, që me pavarësimin e Kosovës ka pësuar ngjitje, pra shpallur si nëntekst është bërë gjysma e udhës, e mbetet si proces bashkimi kombëtar. Në vargjet: “Kur prapë po agonte/Dita e Shqiptarit/Kosova na ishte/ylli polar” e poezisë “Drejt himnit të ri”, më shumë se tjetërkund zbulohet lidhja e fortë e autorit, me fatin e shqiptarisë. Prania e dy elementëve të

rëndësishem shkrimorë, nga njëra anë të lëvrimit gjerësisht të vargëzimit të lirë, në jo pak herë, të plazmuar nëpër shëmbëltime të befta metaforike, si dhe të lëvrimit të gegnishtes, gjuhës së Buzukut, Fishtës, e rrit më tepër gradacionin shprehës, duke dëshmuar përpjekje për të komunikuar me lexuesin, me një mënyrë ligjërimi, gati-gati të lënë jashtë rrjedhës së sistemit të gjuhës shqipe. Klithma e krenarisë së pakufij, shqiptohet në vargjet: “O tokë e fëmijëve jetima,/me prindër heronj,/me shekuj e djegur nga vetëtimja,/nga dardanët e punuar me thonj” e poezisë “Curriculum vitae”, e derdhur në laryshi vargësh si një akuzë kozmike mbi shkaktarët e humnerës së endur, për fatin e trojeve dhe të qenies arbnoe.

Krahas trajtimit gjerësisht të poezisë atdhetare, ndeshesh me vargje që kanë në fokus një rrafsh më emocional, mbase më tronditëse, siç është tema për të birin, ku në vargjet: “Jam në majë të bjeshkës sime,/nga ku shoh një rrugë për në bjeshkën tjetër,/edhe ma të naltë,/ku unë nuk mund të shkoj”, e poezisë “Birit”, e sjellur përmes metaforës së dhimbjes së fshehur. Djega e madhe ia ka përvëlur shpirtin, siç edhe ngjet në vargjet e poezisë “Bushatit”, teksa këndon fatin e djalit: “Askund nuk e ndiej,/trupin ma të lehtë,/shpirtin ma të dëlirë,/as mendjen ma të shlrë,/se mbi varrin tënd bir,/kur vij e i lutem shqip,” ku dhimbja e pakufij shprehet në gjuhën e ëmbël shqipe.

Vëllimi poetik “Gjysma e rrugës”, për mesazhet domethënëse në marrëdhënie me atdhetaren, vargjet e matura dhe të lira, poetikës melodike dhe ritmike, ligjërimit të poezisë më anë të gegnishtes, të një formësimi metaforik, me anësim kah përveçësia, të ngjallë kureshtje për ta lexuar, me shumë gjasa edhe për t’u kthyer në rilexim.

BEHAR GJOKA

## LETËRNJOFTIM

Jam shqiptar në Mal të Zi,  
jam Kosovë e jam Shqipëri,  
unë jam Gjergj e jam Adem,  
autokton denbabaden.

## PËRFAQËSUESIT

Si e ke dashtë e mbrojtur shqiptarinë,  
e amanetin e Ismail Qemalit,  
e paç kokën dhe shtëpinë,  
brez pas brezit e djalë pas djalit!

## CURRICULUM VITAE

O tokë e fëmijëve jetima,  
me prindër heronj,  
me shekuj e djegur nga vetëtima,  
nga dardanët e punuar me thonj!

Prapë të Lindjes së Madhe,  
kur të dëgjohen brimat,  
prindër do t'i bësh jetimat.

## BINJAKË SIAMEZË

Erdhi e m'tha  
ky që kishte lindur më vonë  
e kishte vdekur më parë.

Ndoshta edhe s'do t'më njihje  
po t'mos ishte ai  
që lindi më parë e vdiq më vonë.

S'e pa lëkurën e tij të trashë,  
e mendjen e tij të hollë,  
mund të digjesha herët,  
sa për t'u bërë hi,  
në shishen e hedhur në Danub  
në vend se ç'u dogja më vonë,  
e u bëra fotografi  
në xhepat e uniformës së çlirimtarëve,  
të cilët po kaliteshin n'egzil,  
ose para tytave t'sistemit paralel  
të cilit ai po i printe  
dhe afër po i rrinte  
siç i rri arkitekti  
shtyllës bartëse të godinës  
rezistente n'tërmete  
të ndërtuar me betonarme  
*made in USA.*

Erdhi e m'tha,  
aman mos na i luani eshtrat në varr,  
në pole të kundërta duke na hequr zvarrë  
sepse ne binjakë siamezë jemi  
dhe në lindje njëri-tjetrin ndihmuar kemi.

Ai mua me paqen  
unë atë me luftën.

Ne vetëm bashkë frymojmë  
ne vetëm bashkë do t'jetojmë  
në tokën e ndarë të Ilirisë  
në tokën e bashkuar të Shqipërisë.

## BIRI YT KRENAR

As Prizreni i Çun Mulës,  
as Bratila e Dedë Gjo' Lulit  
s'të bënë bashkë Malësia e Madhe.

Por ti je e madhe edhe dyshë,  
edhe e ndarë ti ke emër,  
edhe kur të kam larg sysh,  
gjithnjë t'kam në mendje e zemër.

Edhe me kafshatë në fyt  
prapë krenar është biri yt.

Se kur shkoj në Prizren,  
e gjej Çunin në muze.  
Në Tiranë kur rruga m'bjen  
Deda n'bronz gjoksin nxe'

Që të dy një fjalë ma thonë,  
s'jem një trup, por një shpirt jemi.  
N'flatrat shqipes përgjithmonë  
kahdo t'hapur një nënë kemi.

## BIRIT

Jam në majë të bjeshkës sime,  
nga ku shoh një rrugë për në bjeshkën tjetër,  
edhe ma të naltë,  
ku unë nuk mund të shkoj.  
Por pres këtu birin,  
për të më thënë solemnisht,  
nën tingujt e këngës sonë shqipe,  
se po niset për në bjeshkën tjetër,  
ku do të pres djalin e tij,  
e ky të vetin  
te maja e bjeshkës së radhës.

Dhe kështu Zoti n' dashtë,  
naltë e ma naltë,  
bjeshkë pas bjeshke e mal pas malit,  
gjysh para gjyshit e djalë pas djalit,  
derisa të gjejmë Tokën e Lashtë.

## BREGUT T'CEMIT

Bregut t'Cemit tue dalë,  
shikoj ujin valë-valë,  
edhe shkambin palë-palë,  
Zot i Madh që i ke falë,  
a më thua ndonji fjalë,  
për atë ma të voglin djalë  
që p'e len nusen pa marrë,  
tue m'ja shty vaden zvarrë.  
E aq shumë gjithë e ka dasht  
gjithë janë ken si mish e asht.

Pse të pyes kur e di vetë,  
çift i rrallë kanë për me met.

Mish e asht do t'jenë përherë,  
por një ditë si n'atë pranverë,  
me dasmorë e zakon t'vjetër,  
dhan'ërr bahet vllau tjetër.

E Teuta n' derët' oborrit,  
afër Gjinit të Kotorrit,  
atij shkambi palë-palë  
krejt mbi detin valë-valë  
vllaut t' vogël i çon fjalë.

Lenia nuses pajën palë,  
e pranvera sa të dalë  
pa e ba nuse, bane me djalë.

## CAKU

Rruga nuk humbet  
nëse i bihet  
Arkitekti kah ka nis  
duke ruajtur çdo lis  
derisa mollat e Atlantikut  
të thyenin hundët e çetnikut

Nuk ishte çudi që u ngazëllyem  
e dolëm për t'festuar  
një kokë një plis

Por s'bënte të nguteshim  
e ta rrenim Komandantin  
se u bitis

Ende ka rrugë deri te caku  
fushave kah rrjedhë Potomaku.

## ÇLIRIMTARËT

Çlirimtarët po na i merr,  
gjyqi ynë i Hagës.  
E kem' lënë gjatë kufomën n'terr,  
pa iu parë vijat vragës.

Tash ata që qitën molla,  
n'atë pranverë  
do t'pyesin për çështje t'holla,  
dhe për çlirimtarët e tjerë.

## DARDANI E DANICA

Punonin në të njëjtën godinë,  
dhe shpesh mbi tavolinë,

në kabinetin e Dardanit,  
Danica rrast i k'cente tupanit,

saqë i bëhej trupi vaj,  
dhe qime shkuleshin nga flokët e saj

Vite me radhë kështu  
derisa erdhi këtu  
dhe u tha burrave e grave,  
*vama ne sme da fali dlaka s glave*<sup>1</sup>.

Policia shtonte dhunën  
shqiptarët braktisnin punën.  
Po t'kajsha nonën more Millosh,  
ton qa po bon ki mi pas bosh.

---

<sup>1</sup> qimen e flokut s'guxon kush t'ua pre ë

*Pa znaš bre kako šiptar tuca<sup>2</sup>  
jednostavno dok mi se štuca<sup>3</sup>  
i kad me vidi Miloško zamuca<sup>4</sup>.*

Prishtinë, 1990

---

<sup>2</sup> A e di ti si shqiptari pallon

<sup>3</sup> gjithnjë derisa lemza m'fillo

<sup>4</sup> dhe kur më sheh Miloško belbon

## DJALOSHI I SHQIPËRISË SË NDA LUAR

As llahtari i territ të kanjonit,  
të Cemit të shterur,  
s'më ndalte të merrja me kovë ujë,  
në pellgun e mbetur,  
e me thes të grisur nënës vjedhur,  
sipër në gurin e lëmuar të shtratit,  
emrin e shkruar me kllak të shlyeja.

Fillikat vetëm i pa brisk në mjekër,  
të prishja natën,  
punën që kishin bërë ditën,  
aktivistët e vjetër.

Nuk dija qartë pse Titon s'e doja,  
por e dija se nuk guxoja,  
radio "Tiranën" të dëgjoja,  
as në Shqipëri të shkoja,  
dhe mbiemrin e kisha më të gjatë se ç'doja.

E dija se shkrihesha për shokun Enver,  
pa ditur se po bënte tmerr,  
në shtetin tim amë,  
në Shqipërinë e ndaluar.

## DREJT HIMNIT TË RI

Kur prapë po agonte  
Dita e Shqiptarit  
Kosova na ishte  
ylli polar.

Drejt himnit të ri  
tash dritë na bëjnë  
një Arkitekt  
dhe një Legjendar.

## FJALA

Ti që e dije se ç'kam,  
e kisha shkri,  
për një tamam Shqipëri,  
pse heshte,  
kur ush e marush,  
e qorr e horr,  
e subash e udbash,  
me akuzonin për tradhti  
se në Mal të Zi,  
po ndihmoja ata  
që punonin për pavarësi?

Nganjëherë,  
fjala e pathënë e t'mirit  
dhemb më shumë  
se fjala e thënë e t'keqit.

## FQINJIT

Ç'se erdhe tokën time,  
e quajte t'vetën.  
Dhe me mite t'rrejshme e krime,  
shtrembëroje t'vërtetën.

Të kishte çuar e mira peshë,  
Duke mos lënë paqe kurrë mes nesh.

Tash kur erdhi koha ime,  
as pas krimeve të reja s'po të lypi hak,  
dhe po të thërras për tjera rrugëtime,  
nëse për duart tua me gjak,  
që më shtuan heronj e martirë  
ulesh në gjunjë e kërkon ndjesë,  
puth dorën time të shtrirë,  
dhe japim të dy të vetën pjesë,

për paqen që na pret,  
secilin në tokën e vetë.